



Pranuar / Dorezuar Primito / Predato Received / Delivered	01.11.2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHICK	6810/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1257/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1257/2023 të datës 05.10.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë rruga [redacted] në Pejë, kundër Vendimit Nr.Prot: 01-112/01-0098568/2023 të datës 04.10.2023 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Pejës, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1257/2023 e datës 05.10.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. Shfuqizohet Vendimi Nr.Prot: 01-112/01-0098568/2023 i datës 04.10.2023 i Komisionit të Pranimit në Komunën e Pejës, Njoftimi mbi rezultatet përfundimtare i datës 29.09.2023 dhe vlerësimi i jetëshkrimit për procedurën e pranimit e shpallur sipas Konkursit me Nr. Reference: RN00012111 të datës 18.07.2023 për grupin "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm", për pozitën e punës "Zyrtar për Shërbim me Qytetarë", ndërsa procedura kthehet në rishqyrtim në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit të kandidatëve tek Komisioni i Pranimit.

III. Obligohet Komisioni i Pranimit në Komunën e Pejës i caktuar për këtë procedurë pranimi, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit, të ndërmer veprimet e nevojshme administrative që procedura e pranimit si në pikën II të vazhdoj nga faza e vlerësimit të jetëshkrimit.

IV. Obligohet Kryetari i Komunës së Pejës, të kujdeset që zbatimi i këtij vendimi të bëhet si në pikën III.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Komuna e Pejës më datë 18.07.2023 ka publikuar Konkursin me Nr. Reference: RN00012111 për grupin "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm", për pozitën e punës "Zyrtar për Shërbim me Qytetarë", për klasën e pozitës profesional 3, ku afati për aplikim ka qenë nga data 08.08.2023 deri me datë 15.08.2023, e në të cilin ka aplikuar edhe ankuesi, i cili është përfshirë në testin me shkrim dhe i është bërë vlerësimi i jetëshkrimit. Në bazë të formularit të vlerësimit ankuesi në testin me shkrim është vlerësuar me gjithsej 44 pikë ndërsa në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit është vlerësuar me 10 pikë, kështu që nuk i është nënshtruar intervistës me gojë për shkak që nuk ka marr numrin e mjaftueshëm të pikëve për vazhdim të procedurës së më tutjeshme.

Pas përfundimit të procedurës së pranimit, më datë 29.09.2023 është publikuar njoftimi për rezultatin përfundimtar, ndërsa ankuesi më datë 01.10.2023 ka parashtruar ankesë ndaj mënyrës së vlerësimit të jetëshkrimit. Komisioni i Pranimit i Komunës së Pejës më datë 04.10.2023 ka nxjerrë Vendim me Nr.Prot: 01-112/01-0098568/2023 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi njoftimin për rezultatin përfundimtar.

Ankuesi kundër Vendimit Nr.Prot: 01-112/01-0098568/2023 të datës 04.10.2023 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Pejës, më datë 05.10.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6414/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Pejës. Ndërsa kjo fundit më datë 17.10.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në shqyrtim.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6414/2023 e datës 05.10.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.Prot: 01-112/01-0098568/2023 të datës 04.10.2023 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Pejës; Ankesën e datës 01.10.2023 e parashtruar nga ankuesi; Dokument identifikimi i ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 09.10.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 17.10.2023; Konkursin me Nr. Reference: RN00012111 të për grupin "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm", për pozitën e punës "Zyrtar për Shërbim me Qytetarë"; Lista e aplikantëve; Njoftimin i datës 21.08.2023 për verifikim paraprak; Vendimin e datës 22.08.2023 për formimin e Komisionit të Pranimit; Njoftimin për testin me shkrim i datës 31.08.2023; Lista e vlerësimit të testit me shkrim dhe jetëshkrimit; Njoftimin për rezultatin përfundimtar i datës 29.09.2023;

Aplikacionin e ankuesit, Diplomën me Nr. 1295/17, Diplomë me Nr. 2026/20, Certifikatën e datës 25.04.2018, Certifikatën e datës 30.03.2018, Certifikatën për periudhën 26.11.2020 deri 22.06.2021, Kontratë për punë për kohë të caktuar e datës 01.01.2023, Marrëveshje për angazhim në praktikë pune e datës 13.04.2023, Marrëveshje e mirëkuptimit për praktike në punë me Nr. 143/1, Letër rekomandimin e datës 06.03.2019, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 26.05.2023; Aplikacionin e kandidatit K.B, Dokument identifikimi, Diplomën me Nr. D-173, Diplomën me Nr. 2239/20, Certifikatën e datës 01.09.2019, Certifikatën 27-28.09.2018, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 09.08.2023, Pasqyrën e llogarisë nga Trusti datë 29.12.2010 deri 04.08.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është *e bazuar sepse*:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.Prot: 01-112/01-0098568/2023 të datës 04.10.2023 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Pejës, pretendon se vlerësimi i jetëshkrimit është bërë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Konkursi me Nr. Reference: RN00012111 të për grupin "*Specialist i Administrimit të Përgjithshëm*", për pozitën e punës "*Zyrtar për Shërbim me Qytetarë*", si kriteret të përgjithshme formale kanë qenë:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve. Arsim i lartë i paspecifikuar*
- *Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase;*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet.*

Me qëllim të shqyrtimit të vetmit pretendim të ankuesit ndërlidhur me vlerësimin e jetëshkrimit, dhe provave materiale të lëndës respektivisht formularët e vlerësimit të jetëshkrimit, Kolegji i Këshilli, konstaton se anëtarët e Komisionit të Pranimit me rastin e vlerësimit të jetëshkrimit kandidatët i kanë vlerësuar vetëm për cilësinë dhe nivelin të arsimit dhe për trajnimet, ndërsa për përvojën e punës të gjithë kandidatët i kanë vlerësuar me zero (0) pikë, rrjedhimisht me qëllim të shqyrtimit të mëtejme të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 22 paragrafi 2, 3 dhe 4 nën paragrafi 4.1, 4.2 dhe 4.3 të Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: "2.Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën dyzet (40) pikë në testimin me shkrim, i nënshtrohen vlerësimit të jetëshkrimit. 3.Vlerësimi i jetëshkrimit konsiston në vlerësimin e cilësisë dhe nivelit të arsimit, të përvojës domethënëse në punë dhe të trajnimeve që lidhen me vendin e punës në lëmin përkatëse të lidhur me Grupin për të cilët zhvillohet konkurrimi. 4.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri në njëzet (20) pikë, të ndara, si vijon: 4.1. deri në tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin të arsimit; 4.2. deri në shtatë (7) pikë për përvojën domethënëse në punë; dhe 4.3. deri në pesë (5) pikë për trajnimet", ndërsa në bazë të këtyre dispozitave Kolegji i Këshillit, ka ardhur në përfundimin se



anëtarët e Komisionit të Pranimi të cilët të gjithë kandidatët në procedurën e vlerësimit të jetëshkrimit i kanë poentuar me zero (0) pikë kanë vepruar gabimisht, ngase të njëjtit është dashur ta kenë parasysh faktin se poentimi me zero (0) pikë është vlerësim negativ dhe jo mos vlerësim sikurse janë arsyetuar në vendim, nga rrjedh se meqenëse çështja e vlerësimit të përvojës së punës është kriter obligativ sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, atëherë në rastet kur për një pozitë të shpallur nuk kërkohet përvojë punë, vlerësimi duhet të jetë maksimal, pra shtatë (7) pikë pa dallim për të gjithë kandidatët, pasi që duke i referuar nenit 22 paragrafi 5 të Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës përcaktohet se: *“Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimi, bën vlerësimin e detajuar për secilën prej faktorëve të përcaktuara në pajtim me paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni. Vlerësimi përfundimtar i jetëshkrimit për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve të të gjithë anëtarëve”*, nga kjo rrjedh se vlerësimi me zero (0) pikë për një fushë e cila nuk është e kërkuar sipas kriterëve të konkursit i dëmton kandidatët në procedurën e vlerësimit sipas mesatares së përgjithshme aritmetike, pasi që vetëm kandidatët që arrijnë të grumbullojnë 60 pikë nga vlerësimi i testimit me shkrim dhe jetëshkrimit kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë me gojë sikurse përcaktohet me nenin 23 paragrafi 2 të Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës.

Prandaj, sikurse u tha më lartë, mbi bazën e shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstatimeve të dhëna si dhe analizimin e dispozitave ligjore të ligjit material dhe rregullores së lartcekur, Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se Vendimi Nr.Prot: 01-112/01-0098568/2023 i datës 04.10.2023 i Komisionit të Pranimi në Komunën e Pejës është i paligjshëm sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material”*, ngase Komisioni i Pranimi nuk ka arritur të shqyrtojë meritorisht pretendimin e palës ankuese.

Nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se ka mbetur në fuqi Konkursi me Nr. Reference: RN00012111 të për grupin *“Specialist i Administrimit të Përgjithshëm”*, për pozitën e punës *“Zyrtar për Shërbim me Qytetarë”*, sikurse edhe vlerësimi i rezultateve me shkrim, ndërsa Komisioni i Pranimi duhet të zhvillojë procedurën nga faza e vlerësimit të jetëshkrimit, dhe me rastin e rishqyrtimit të lëndës duhet të respektojë vërejtjet e dhëna juridike në arsyetimin e këtij vendimi.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari e Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1257/2023, datë 01/11/2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Pejës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.